



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 01.3.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e planit vjetor për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Blerina Gjylameti, Senida Mesi, Pjerin Ndreu, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungon:

Vullnet Sinaj.

Të ftuar:

Maldi Dema - Drejtor i Drejtorisë së Kordinimit dhe Çështjeve Ligjore

Elsa Dhuli - Drejtore e Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real

Elona Sevrani - Drejtore e Drejtorisë së Llogarive Kombëtare

Etugert Llazi - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave Ekonomike

Kledia Ramizi – Specialist në Sektorin e Kordinimit dhe Planifikimit Strategjik
(PSZ-së)

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Fillojmë.

Kuorumin e kemi gati.

Në rendin e ditës së sotme, datë 1 mars, kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e planit vjetor për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021”.

Mungon relatorja dhe relatimin do ta bëjë zonja Evis Kushi.

Është i pranishëm i gjithë grupi, me përjashtim të drejtoreshës që është në New York për Konferencën Botërore të Statistikave të Botës.

Maldi, fjala është për ju.

Ju lutem, shkurt, sepse jemi shumë të qartë për planin, e kemi kaluar tri herë deri tani.

Maldi Dema – Patjetër.

Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektplani vjetor 2019 është dokumenti i parë i këtij lloji, i cili paraqitet për miratim në Kuvendin e Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10 të ligjit për statistikat zyrtare. Ky dokument shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjike, si dhe rezultatet e pritshme të parashikuara në programin e statistikave zyrtare 5-vjeçare, 2017-2021, miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 10, datë 9.2.2017.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit për statistikat zyrtare, INSTAT-i është përgjegjës për përgatitjen e planit vjetor në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme të vitit 2019, si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Sistemi Kombëtar Statistikor është tërësia e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare, të cilët ushtrojnë aktivitet brenda territorit shqiptar, mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë statistika zyrtare sipas programit. Aktualisht, referuar programit ekzistues 2017-2021, sistemi përbëhet nga tri institucione, që janë INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Përmbajtja e projektplanit vjetor është në linjë të plotë me kërkesat e nenit 17 të Rregullores nr. 223/2009 të Parlamentit Europian, që ka për qëllim ngritjen e kornizës ligjore në përputhje me standardet e kërkuara të BE-së dhe Eurostat-it, në bazë të cilës ushtrojnë aktivitetin Sistemet Kombëtare Statistikore të vendeve anëtare. Aktivitetet janë parashikuar në projektplan, ku janë, gjithashtu, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në fushën e statistikave, veçanërisht të atyre që kanë të bëjnë me përmirësimin e statistikave makroekonomike, statistikave të bujqësisë, statistikave strukturore të ndërmarrjes apo atyre të mjedisit dhe energjisë. Në mënyrë që të pasqyrohet i gjithë informacioni i duhur, projektplanin vjetor përbëhet në dy pjesë, ku në pjesën e parë paraqitet një informacion i përgjithshëm për përmbajtjen dhe pasqyrohen objektivat strategjike të përcaktuar në programin 5-vjeçar, por edhe aktivitetet për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, në to përshkruhen shkurtimisht aktivitetet statistikore që do të kryhen në secilën fushë, përcaktohen institucionet përgjegjëse për prodhimin dhe institucionet që janë të detyruara të japin të dhëna administrative. Më tej, në fund të çdo teme listohen treguesit kryesorë statistikorë që do të prodhohen.

Pjesa e dytë përbëhet nga aneksi, i cili është hartuar sipas klasifikimit të përcaktuar në shtojcën 1 të ligjit të statistikave zyrtare, në nivelet fushë, temë dhe nëntemë, duke ndjekur përmbajtjen e programit për çdo modul. Përputhja e moduleve me temën është në linjë me klasifikimin statistikor dhe kompendiumin e Eurostat-it 2017. Çdo aktivitet statistikor i parashikuar për një temë, shoqërohet me kodin e aktivitetit, emërtimin, periodicitetin, afatin e grumbullimit të të dhënave, afatin e publikimit të të dhënave, institucionet përgjegjëse për furnizimin e të dhënave, institucionet përgjegjëse për publikimin, risqet e mundshme dhe nivelin e këtyre risqeve.

Ju falënderoj paraprakisht për mbështetjen dhe jemi në pritje të miratimit të projektvendimit!

Anastas Angjeli – Faleminderit!

Fjalën e ka relatorja, zonja Blerina Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Për të mos përsëritur ato që u thanë në pjesën e prezantimit, unë do të mbaj fjalën time shkurt në pjesën e raportit që është hartuar nga komisioni.

Projektplanin vjetor i vitit 2019 për zbatimin e programit të statistikave zyrtare 2017-2021 është përgatitur nga INSTAT-i dhe është paraqitur në Kuvend nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 9 dhe 10 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikatat zyrtare”.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektplan në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit. Sipas ligjit për statistikën zyrtare Kuvendi miraton planin vjetor brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së tij nga Këshilli i Ministrave. Projektplanin vjetor 2019 përgatitet për herë të parë në vendin tonë, mbështetur në kërkesat e ligjit, programi i statistikave zyrtare dhe standardet që dalin nga rregullorja e KE-së 223/2009 për statistikën europiane. Qëllimi i tij është përcaktimi i aktiviteteve dhe treguesve statistikorë që do të prodhohen nga sistemi kombëtar statistikor për vitin 2009.

Për të mos u zgjatur më shumë, do të përmend disa nga zhvillimet kryesore të vitit 2018.

Së pari, miratimi në vitin 2018 i ligjit të ri për statistikën zyrtare, i cili është një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet europiane. Përparësitë që solli ligji ishin forcimi i pavarësisë profesionale të INSTAT-it, forcimi i rolit udhëheqës të INSTAT-it në prodhimin e statistikave zyrtare, forcimi i mandatit të prodhuesve statistikorë për të drejtën e hyrjes në të dhënat administrative, si dhe zgjerimi i autonomisë së INSTAT-it për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta.

Së dyti, gjatë vitit 2018 INSTAT-i u fokusua në fillimin e punëve përgatitore për censusin e ardhshëm të popullsisë dhe banesave. Për këtë qëllim u përgatit projektligji për censusin e popullsisë dhe banesave, si dhe drafti i parë i pyetësorit të censusit, i cili do t'u nënshtrohet më tej pilotimeve dhe konsultimeve të tjera.

Së treti, ndikim të rëndësishëm pati edhe kontributi i INSTAT-it për ngritjen e qendrës së trajnimit statistikor për të hartuar plane për rritjen e kapaciteteve profesionale të staticienëve.

Së katërti, në vitin 2018 u vendos në funksion sistemi i përdorimit të kohës, i cili ka për qëllim matjen me eficiencë të kostos së produkteve statistikore.

Viti 2019 përmban disa detyrime për INSTAT-in, si, së pari, zbatimin e projektit pilot për censusin e popullsisë dhe banesave 2020.

Së dyti, implementimin e strukturës së re organizative të INSTAT-it.

Së treti, fillimin e punës për auditimin statistikor. Pa u zgjatur më shumë dhe pa dashur të përsërisim të gjitha çfarë u thanë në pjesën e prezantimit, si konkluzion, projektplanin e statistikave zyrtare për vitin 2019 është një detyrim që rrjedh nga ligji për statistikën zyrtare, programet e statistikave zyrtare dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare. A është i hartuar në përputhje me këto dy dokumente dhe për këtë arsye i

propozoj komisionit miratimin e projektvendimit të Kuvendit për miratimin e këtij projektplanit.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja relatore!

Ka pyetje dhe komente? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në tërësi, sepse praktikisht është plan, nuk ka nevojë për asgjë tjetër. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Sot, më 1 mars, kaluam planin e statistikës dhe do ta bëjmë gati për të martën në seancë.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti